

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit (Fillor)
Titulli i lëndës:	Bazat e metodologjisë së mësimdhënies në muzikë
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	(Sem II)
Numri i orëve në javë:	3+1 për Programin fillor
Vlera në kredi – ECTS:	7 ECTS
Koha / lokacioni:	08:30-10:30
Mësimdhënësi i lëndës:	Mr. Festa Nevzati Thaçi
Detajet kontaktuese:	festanevzatithaci@gmail.com
Përshkrimi i lëndës	<p>Përmes disiplinave artistike, fëmijët e moshës më të hershme, në mënyrën më të përshtatshme për ta, manifestojnë përmes formës së lojës, si prirjet dhe shkathtësitë e veta, ashtu edhe përjetimin dhe njohjen e vetvetës e të botës që i rrethon.</p> <p>Reagimi i nxënësve ndaj tingujve të ndryshëm gjatë procesit të këndimit dhe të interpretimit me vegla muzikore duhet të stimulohet përmes hulumtimit të tingujve dhe interpretimit të tyre mbi gjithçka që i rrethon ata. Instrumentet nga instrumentari i Orfit¹ arrijnë t'i plotësojnë mundësitë e shumëllojshme të krijimit të tingullit ose të ritmit me të cilët ndiqen këngët dhe fjalëshpejtat (hapadollapat).</p> <p>Këndimi dhe interpretimi bashkarisht ndihmon edhe në zhvillimin social të fëmijës, si komponentit qenësor të rritjes së tij, i cili përmban tolerancën e ndërsjellë, ndjenjën e punës ekipore, barazinë, shoqërimin dhe gëzimin e krijimit të përbashkët.</p> <p>Edukata muzikore në shkollimin e përgjithshëm ka për detyrë t'u krijojë mundësi studentëve të aftësohen para së gjithash për:</p> <ul style="list-style-type: none"> -dëgjim selektiv dhe aktiv të muzikës në programet e shfaqjeve muzikore;pjesëmarrje në formacione korale dhe veprimtari të tjera muzikore; -arsimim të mëtejshëm, që nënkupton interesim më të gjerë me përgatitje për ndonjë profesion ku muzika është pjesë përbërëse. <p>Kursi është i ndarë në disa pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Njohja me instrumentin, mundësitë teknike pjesët e tijë, mënyra

¹ Karl Orfi (1895-1982), kompozitor dhe pedagog gjerman. Ka shpikur grupin e instrumenteve të njohur me emërtimin instrumentet e Orfit

	<p>e interpretimit, rikujtimi teorik dhe interpretimi i shkallëve (C,G,me dy uarD,A,E,H,FIS,CIS, F, B, ES, AS, DES, GES,CES.me nga një dorë,</p> <p>-Intepretimi i shkallëve (a,e,me dy duar h,fis,cis,gis,dis,ais,d, me dy duar g,c,f,b,es,as, me nga një dorë.</p> <p>- Interpretimi i këngëve të ndryshme me specifika të grupmohës për nivelin zero dhe të parë të shkollimit, përkatësisht klasat 0-5.</p> <p>-Interpretimi i këngëve në piano dhe në veglat e Orfit.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i lëndës " Bazat e metodologjisë së mësimdhënies në muzikë" është të aftësuarit e studentëve në aspektin teorik dhe praktik për të interpretuar në instrumente si në ato ritmike (të ORFIT) ashtu edhe ato melodike (piano). Duke u fokusuar më tepër në ushtrimet praktike në instrumentet me taste piano (piano elektrike) sepse mundësia e përvetësimit është më e lehtë. Kjo do të arrihet në ligjërata,punë praktike, demonstrime të teknikave, ushtrime, punë individuale dhe grupe.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të njohë konceptet themelore nga të interpretuarit në instrument 2.Të kuptojë rëndësinë e instrumentit dhe mundësitë që u ofrojnë studentëve interpretimi në realizimin e edukates muzikore. 3. Nëpërmjet lëndës " Bazat e metodologjisë së mësimdhënies në muzikë"studentët do të njihen me rolin e instrumentit-ve, mundësitë teknike të tij-tyre si dhe zotërimin për interpretim. 4.Të aftësohen për punë ekipore në interpretim grupor-kolektiv. 5. Formojnë qëndrim të drejt ndaj interpretimit dhe edukimit muzikor, fitojnë shkathtësi për interpretim dhe shprehi pune. 6. Aftësohen për interpretim individual dhe të përbashkët të këngëve që dalin nga programi i edukates muzikore parashkollore. Ky kurs ndikon fuqishëm në formimin e personalitetit të njeriut, në ngritjen e tij kulturore dhe profesionale.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/ritmike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15

Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezantimet ,etj	3	3	9
Totali			160 orë
177: 25 ≈ 7 ECTS.			
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, Ushtrime, Puna grupore, Puna individuale, Puna praktike -interpretim në instrument individualisht		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete: (Koll.) Testi I- 15 % (Koll.) Testi II- 15 % Vijueshmëria 5% Aktivitetet 15% Provimi përfundimtar 50 % Nota përfundimtare: Pikët (%) Nota 91 -100 - dhjetë (10) 81 - 90 - nëntë (9) 71-80 - tetë (8) 61-70 - shtatë (7) 51-60 - gjashtë (6)		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Atabey, Tayfun, kompozitor i këngëve për fëmijë, libri " Küçük Karınca" 2.AKKAS,Salih (1991), Okul Öncesi Eğitimde müzik, Ankara		
Literatura shtesë:	Tekste shkollore për lëndën e muzikës, niveli parafillor (0)		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Qëllimi, Rëndësia, rezultatet , kriteret dhe kompetencat		
Java e dytë:	Leximi i notave dhe vlerat ritmike		
Java e tretë:	Interpretimi i shkallëve dur me diezisa (C,G, D,A,E,H,FIS,CIS) Interpretimi i shkallëve dur me bemola(F,B,ES,AS,DES,GES,CES). me nga një dorë		
Java e katërt:	Interpretimi me instrument i këngës: Kuş uçar şarkısı ;Uyarlama, Ziya Aydın -Şaip Egüz		
Java e pestë:	Interpretimi me instrument i këngës:Kış; Söz-Müzik:Tayfun Atabey		
Java e gjashtë:	Interpretimi me instrument i këngës:ilkbahar; Söz-Müzik:Tayfun Atabey		
Java e shtatë:	Testi 1		
Java e tetë:	Interpretimi me instrument i këngës:Fidan Dik; Söz-Müzik:Tayfun Atabey		
Java e nëntë:	Interpretimi me instrument i këngës:Dünyaya çağrı; Söz-Müzik:Tayfun Atabey		

Java e dhjetë:	Interpretimi me instrument i këngës:Kelebek Çocuk; Söz-Müzik:Tayfun Atabey/Niyazi Nasifoğlu
Java e njëmbëdhjetë:	Interpretimi me instrument i këngës:Küçüğüme Öğüt; Söz-Müzik:Tayfun Atabey
Java e dymbëdhjetë:	Interpretimi me instrument i këngës:Küçük Karınca; Söz-Müzik:Tayfun Atabey
Java e trembëdhjetë:	Interpretimi me instrument i këngës:Masallar; Söz-Müzik:Tayfun Atabey
Java e katërbëdhjetë:	Interpretimi me instrument i këngës:Notalar; Söz-Müzik:Tayfun Atabey
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi 2

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në çdo aktivitetet.

- Gjatë orëve mësimore dhe provimeve nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë.
- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye
- Studenti ka të drejtë të merr pjesë në teste dhe ne Provim nga lënda "Bazat e metodologjisë së mësimdhënies në muzikë" kur vijueshmëria është së paku 80% nga numri i përgjithshëm i orëve të planifikuara për semestër.